



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 515/22

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Rasim Rasimi, kryesues i Panelit, Delushe Halimi dhe Shpresa Hasaj Hyseni, anëtarë të panelit, me pjesëmarrjen e Adelina Jusufi, u.d. koordinatore e panelit, duke vendosur përkritazi me kërkesën e datës 19.08.2022, për lirim me kusht, të parashtruar nga E. B., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprën penale të mbajtjes, në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 (2) të KPK-së, i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vite, me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.164/10 të datës 08.02.2011, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Ap.nr.173/11, i datës 14.12.2011, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117, 118, 119 dhe 197 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 13, 14, 25 pika 1.2 si dhe 34 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur më 12.10.2022, në selinë e KGJK-së në Prishtinë, mori këtë:

AKTVENDIM

I. APROVOHET kërkesa për lirim me kusht për të dënuarin E. B., i biri i I. dhe i nënës H., e lindur G., i lindur me ..., në fshatin H. e Q., me vendbanim në fshatin H. e Q., Komuna e P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. E. B. do të lirohet me dt. 14.10.2022, dhe do të jetë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës deri me dt. 09.09.2023.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.164/10 të datës 08.02.2011, E. B., është shpall fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprën penale të mbajtjes, në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 (2) të KPK-së, i gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vite, i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Ap.nr.173/11, i datës 14.12.2011.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, paneli për lirim me kusht ka shqyrtuar raportin përmbledhës të përpiluar nga ekipi profesionist i Shërbimit korrektues të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 par. 6 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr. 08/ L – 132.

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lartë, paneli ka gjetur se:

Lirimi i zakonshëm për të dënuarin është caktuar me 09.09.2023. I dënuari deri me tani ka vuajtur 8 vjet e 1 muaj e 3 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 10 muaj e 27 ditë, të cilat do të mbikëqyren dhe kontrollohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Në raportin përmbledhës të Qendrës Korrektuese konstatohet se i dënuari ka treguar sjellje të mira, është i angazhuar në punë. Procesi i risocializimit sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese tek i dënuari ka pasur elemente pozitive siç janë sjellja dhe punë ndërsa mos pranimit i veprës dhe po ashtu mos kthimi nga pushimi i rregullt janë efekte se procesi ka pasur ngecje.

Prandaj, Paneli vlerëson se tani është arritur qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 5 dhe 6 të LESP-së, lidhur me nenin 38 të KPRK-së, duke marrë parasysh faktin se i dënuari ka treguar sjellje të mira, qëndrimi i tij personal në raport me vuajtjen e dënimit dhe efekti i burgosjes tek i dënuari ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e tij, por gjithashtu edhe koha e mbetur në përpjesëtim me kohën e vuajtur ngase ky person ka vuajtur me shume se 2/3 e dënimit qysh prej datës 14.06.2016, si dhe premtimi i dhënë zyrtarit të Shërbimit Sprovues të Kosovës së do të bashkëpunojë me këtë shërbim deri në përfundimin e mbikëqyrjes së lirit me kusht këto janë rrethana për të cilat konsiderohet se është arritur qëllimi i dënimit. Paneli konsideron se me një mbikëqyrje efektive i dënuari me lehtësi do të ri-integrohet në familje dhe shoqëri në pajtim me ligjin.

Paneli vendosi që ta lirojë me kusht personin e dënuar E. B., ai do të lirohet me kusht me dt.14.10.2022 (e premte ora 16:00), nën kushtet e mëposhtme:

Brenda pesë (5) ditësh nga data e lirit nga burgu të lajmërohet në Drejtorinë Regjionale të Policisë së Kosovës, përkatësisht të Shërbimit Sprovues;

1. të raportojë rregullisht në Shërbimin Sprovues deri me 09.09.2023;
2. në rast të ndërrimit të vendbanimit ta njoftoj policinë dhe shërbimin sprovues;
3. të mos tentojë që të udhëtoj jashtë Shtetit, pa miratimin e Panelit për Lirim me Kusht;
4. të jetë me i kujdesshëm me sjelljet e tij në të ardhmen.

Udhëzim për Qendrën Korrektuese:

Qendra Korrektuese ku personi i dënuar është duke vuajtur dënimin duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I.*** kompletin Aneksin 2 – Komunikimi i Lirit me Kusht Gjykatës kompetente;
- II.*** kompletin Aneksin 2a – Komunikimi i Lirit me Kusht Policisë;
- III.*** kompletin Aneksin 2b – Komunikimi i Lirit me Kusht Shërbimit Sprovues;
- IV.*** i shpjegon plotësisht personit të dënuar kushtet e lirit (obligimet ligjore mbi zbatimin e vendimit - kushtet mbi raportimin dhe pasojat e krimeve tjera).

Udhëzim për Drejtorinë Regjionale të Shërbimit Sprovues:

Drejtoria Regjionale e Shërbimit Sprovues duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I. *Drejtoria përkatëse regjionale e Shërbimit Sprovues duhet që të raportoj jo me larg së tri (3) javë nga data e lirimit të të dënuarit, gjithashtu e mban të informuar panelin me raporte periodike deri në skadimin e kohës së rregullt të dënimit.*
- II. *Zyrtari Sprovues udhëzohet që të fokusohet mbi orientimin e të liruarit me kusht në kuptim të respektimit të kushteve të caktuara sipas aktvendimit të panelit. Duke u bazuar në kohën e lirimit të zakonshëm të dënimit për të dënuarin, ai është dashur që të lirohej me datën 09.09.2023. Prandaj, e rekomandojmë shumë atë që të mban me vete këtë aktvendim mbi lirim me kusht gjatë tërë kohës deri në skadimin e lirimit të tij me kusht, që është caktuar me 09.09.2023.*

Personi i cili është liruar me kusht është i njoftuar me faktin se:

- *lirimi me kusht mund të revokohet, dhe në disa raste duhet të revokohet, nëse i dënuari, gjatë lirimit me kusht kryen një apo me shumë vepra penale (Neni. 91 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Kodi nr. 06/L-074);*
- *i liruari me kusht është i obliguar që të njoftoj policinë dhe shërbimin sprovues brenda 5 (pesë) ditëve të lirimit, për vendqëndrimin e përkohshëm të tij apo saj gjatë periudhës së lirimit me kusht;*
- *gjithashtu personi i liruar me kusht është i obliguar që të raportoj në Shërbimin Sprovues gjatë periudhës së lirimit me kusht;*
- *Nëse i liruari me kusht e ndërron vendbanimin, është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues;*
- *nëse dështon të informoj apo raportoj siç u përmend me lartë, paneli për lirim me kusht mund t'a revokoj vendimin për lirim me kusht (neni 119 paragrafi 4 i Ligjit rr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me nenin 36 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 39) mbi Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht;*
- *gjithashtu nëse dështon që të raportoj para SHSK-së siç përcaktohet në vendim, paneli mund ta revokoj vendimin për lirim me kusht (Neni 119 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale).*

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
PLK. D. nr. 515/22 , datë 12.10.2022**

U.d. Koordinatore e Panelit

Adelina Jusufi

Kryesues i Panelit

Rasim Rasimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 117 par.16 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është e lejuar ankesa.